


mark
gurakuqi



Gjurmë
të padukshme

TREGIME

891.983 - 32

g. 96

MARK GURAKUQI

GJURMË TË PADUKSHME

56282

825

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GIROKASTER

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

GJURMË TË PADUKSHME

I

Dom Prendi me të mbesën, Lezen, qëndronin në dhomë të pritjes. Në fytyrë të tij vijëzohej nji shprehje zemërimi, kurse në atë të Lezes nji shprehje mërzie.

Prifti kishte nisë prapë nga «predikimet» e tij.

I tha:

— Ti s'po duke ma në kishë... Dhe ti e din se...

Ajo e ndërpreeu:

— Të lutem, mos më dëno me ndigjue përrallat e tua! Më dhemb kryet. E, me të thanë të drejtën, kam frikë se shpërthej në gaz. Nji ditë i bana buzët gjak, tue i hangër me dhambë, kah u përpcoqë mos t'ja jepja gazit në mes të kishës. Tue të njohtë si të njoh, më vjen për të qeshë, kur ndigjoj fjalët e tua, kur të shoh, ashtu të devotshëm, si shejt, me atë shprehje prej fëmije e përvujtjnie në fytyrë.

Kësaj here, Dom Prendi u nxeh vërtet:

— Leze, mos e tepro!

Kjo s'e prishi terezinë. Ja priti e qetë:

— Kot e ke që nxhe. Ti e din se të ban keq. Unë thashë të vërtetë. Unë s'jam si ata katundarët e tu...

Dom Prendi mori një pamje të trishtueshme:

— As ata s'po ma venë ma veshin. Veç, edhe nji herë po të lutem. Ta njoh kryet. Por bama qejfin. Që nesër, eja edhe ti! Rri makar nga fundi që ta ndjesh veten ma lirshëm, por eja...

Dhe, meqë e kuptonte se zemërimi s'punonte me atë
krye, shtoi lutës:

— Do të vish?

— Mirë, pra. S'po ta kthej.

Ai u gëzua. E kapi pér dore, e tërhoqi pranë vetes,
e puthi:

— Tash ma bane qejfin.

Pastaj, mbasi e pa që gjendja ishte rregullue, e pye-
ti:

— A hamë?

— Si të duesh. A dishron, ma parë, të të shtroj ra-
kinë me meze?

— Jo, sonte s'due raki. Po pi, tue ngranë darkë, ve-
tëm pak venë. Nga ajo ma e vjetra. Kam nji dreq dhimbje
koke...

Ajo u tall:

— Si e përmend dreqin njeriu i zotit kështu?

Dom Prendi s'foli. Vetëm mendoi me vete: «S'ka
dreq, që ja del. Pak me e ngucë, asht si me ngucë nji fole
me gretha. Veç, prapë, shyqyr që e kam...».

Lezja pregatiti tryezën, solli gjellët e shijshme dhe të
bollshme, që, së bashku me Dom Prendin, i shoqnoi me
venë të vjetër të bardhë. Pastaj, pinë nga nji kafe «hake».

— Ma piq dhe nji — tha Dom Prendi.

— Të ban keq pér tensionin.

— Lene tensionin, më pihet.

Mbas pak Lezja ja pru. Ai e rrokullisi ngadalë, me
andje të veçantë.

Lezja tha:

— Duket se s'po vijnë sonte. A flemë?

— Të presim edhe pak.

— Unë po shkoj me ramë.

— Mirë. Unë po pres.

Ajo doli. Ai e ndoqi me sy, derisa u largue.

Dom Prendi shikoi orën. Dhjeta kishte kalue. Me
sa dukej, atë natë, zor se kishin me ardhë. Ma mirë të
shkonte të binte.

Uli fitilin, mori llambën në dorë dhe u drejtue nga

dhoma e gjumit. U zhvesh, u fut ndër shtresa, por gjumi s'e mori.

Sa kohë kishte kalue? Nji orë? Me siguri ma shumë. Ai përtonte të ngrihej, të shihte orën, që e kishte vendosë mbi tryezën e vogël. Në fund të fundit ç'i duhej të dinte sa ishte ora?

Po pse s'po vinin? «Miqtë» e tij, këtë herë, po e tepronin. Jo se e hante aq shumë malli pér ta, por sepse donte të kishte lajme prej «andej». Dom Prendi s'besonte ma asgja, po urrejtja pér pushtetin popullor e kishte shty të lidhej me armiqtë e vendit. Dhe në këtë s'kishin të banin «bindjet» e tij fetare. Ai s'kishte bindje të tillë. Në këtë urrejtje kishte «hesap», llogari: Vërtet kishat s'ishin mbyllë e njerëzit mund të shkonin në to me ndigjue «fjalën e Zotit», por Dom Prendi e kuptonte se koha e dikurshme kishte kalue. Ai s'ishte ma i pari i fshatit. Të tjerë e kishin fuqinë, ata zgjidhnin e lidhnin. E ai s'mund t'ju binte ndesh. Po kështu edhe me fshatarët e tjerë, edhe në qytete, në gjithë Shqipninë. E, në të ardhmen, kushedi se çmund të ndodhët... Prandaj, kur nji natë ja behën në shtëpi të tij tre «mysafirë» dhe, mbasi hangrën e pinë mirë, ja thanë troç të bashkohej me ta kundër pushtetit popullor, ai pranoi, pa e zgjatë. Diçka të tillë si e kishte dashë, e kishte pritë, megjithëse vetë s'kishte guxue të ndërmerritte ndonji veprim.

Atij ju mbush mendja ma tepër dhe u gëzue shumë, sidomos kur i thanë se fijet e kësaj veprimtarie ishin në dorë të Amerikës. Dom Prendi kishte ndigjue pér «çeta» diversantësh, i kishte ramë në vesh ndonji fjalë pér veprimet e tyne. E, kishte pritë, zemërdridhun, të lidhej në nji fare mënyre me to. E, ja, koha kishte ardhë. Mëdje, i kishin dhanë nji detyrë të randësishme, e kishin caktue përgjegjës në zonën përqark. Ai do të kishte lidhje me njerëzit që do të vepronin në atë zonë. E gjith-

shka do të kalonte nëpër duert e tij. Ishin caktue parullat, kundërparullat që, sipas rastit, ndërronin vendet e takimit. Gjithshka e pregititun me kujdesin ma të madh! Se Dom Prendi s'donte të rrezikohej kot. Për çdo gja duheshin marrë masat e nevojshme, asgja nuk i duhej lannë rastit, nxitimit.

Lajmet, që merrte e conte, tregonin se «çeta» të shumta lëviznin anekand vendit. Madje, mbas 3-4 muajsh, do të fillonte sulmi i përgjithshëm. Do të ishte fundi i komunistëve. Gjithshka do të kthente si ma parë, edhe ma mirë. Se, këtë radhë, do të vinin amerikanët... Italianët, s'kishe ç'të thoshe, ishin njerëz të zot, por prapë s'kishin atë pasuninë e amerikanëve. E, atëhere, Dom Prendi do të kishte ditë si me veprue me këta «kuqaloshët» e fshatit e me të tjerët, atje në N... Le të predikonin pastaj se feja asht opium për popullin!..

E shkundi mendimesh një lëvizje e papritun e Lezes. Ajo u hodh, trembshëm, pastaj u struk e nisi të buzëqeshte. Kushedi se ç'andërr shihte, kë andërronte... Ndonshata Gjinin, nji nga pjesëtarët e grupit. Shpesh kishte «kapë» vështrimet, që ata të dy shkëmbenin. Shpesh, kishte vu re si gjallënohej, si eksitohej Lezja, kur vinte Gjini. I kishte ruejtë, por, deri atëhere, s'kishte mundë të pikaste asgja konkrete. Gjini ishte i ri, i pashëm, i fuqishëm. Ai e dinte se Lezes gjithmonë i kishin pëlqye burra të tillë.

Megjithkëtë, te Lezja ai shihte nji rrezik të madh. Ajo dinte shumë gjana për të, ishte bashkëpunëtore e të gjitha veprimeve të tij kundër pushtetit, dhe Dom Prendi s'ushqente asnji iluzion për «moralin e devotshmërinë» e saj; ai ishte i bindun se Lezja, në rast rreziku, po të shihte edhe mundësinë ma të vogël për të shpëtue lëkuren, do t'i kishte paditë të gjithë...

Gabim, gabim i madh që e kishte futë në «lojë». Veçse ishte detyrue. S'e thoshte për t'u shfajësue, jo. Kjo ishte e vërteta. Që të mos e përziente në këto punë, do të ishte dashë ta largonte. Dhe ai nji flijim të tillë s'mund ta duronte. Tue e mbajtë aty, ishte e natyrshme

që ajo do të njihte çdo fshehëtësi. S'kishte pasë rrugë tjetër. Sa për t'i besue, në asnji mënyrë.

Në heshtjen e thelli të natës, u ndigjuen britmat e hutinit. E para e zgjatun, dy të tjerat ma të shkurtna.

Dom Prendi u hodh nga shtrati. «Ata» kishin ardhë. Hapi dritaren. U përgjegj edhe ai me të njëjtën britmë dhe zgjoi Lezen të shkonte t'u cilte portën.

Ai shkoi në dhomë të bukës; qëndroi në poltronë, serioz, i përbajtun. Kështu e gjetën tre burrat, që hynë brenda, të shoqnuem nga Lezja.

— Kjoftë lavdue Jezu Krishti — thanë ata.

— Përgjithmonë e jetës — ua ktheu prifti.

Dhe, pas kësaj «ceremonie», pyeti:

— Ç'u batë? Isha në merak për ju. S'vuna gjumë në

SY.

Njeni nga tre burrat e armatosun u përgjegj:

— E patëm të vështirë ta kalonim kufinin. E ruejnë shumë. Na u desh me pritë për nji kohë të gjatë.

— Keni ba shumë mirë. Duhet matë çdo hap. A keni hangë?

Diversanti qeshi:

— Jo. Ndonji gja të thatë, sa me mbajtë fryshtë gjallë.

Dom Prendi ju suell së mbesës:

— Leze, na sill ndonji send!

Lezja u drejtue nga kuzhina, por diversanti e kapi për dore:

— Lene, Leze! S'kemi kohë. Duhet të nisemi.

Ajo pyeti, trembshëm:

— Prapë do të kaloni përtej?

Ai buzëqeshi:

— Jo, jo, do të shkojmë në nji bazë tjetër. Do të qën-drojmë dy ditë. Pasnesér, po deshe, na pregatit ndonji darkë të mirë. Si thue?

Vajza s'u përgjegj. Mbante sytë përdhe.

Qe Dom Prendi, që e mori fjalën:

— Mos kij dert, Gjin! Do t'ju shtrojmë nji darkë për shtatë palë qejfe.

Dhe, tue ndërrue bisedën:

- Ele, ç'kemi andej?
- Në rregull. Më dhanë këtë letër. Përgjegjen ta kesh gati pér pasnesër mbrama. Po ti këndeja?
- Asgja me randësi.
- A janë dukë forca të ndjekjes?
- Jo.
- Në S. kanë vra sekretarin e partisë.
- Luej vendit!
- Mos u çudit. Dhe në K. kanë djegë depon e grumbullimit me gjithë shtallat. Si, s'e paske marrë vesh?
- Ti e di që s'duhet të bie në sy, të pyesja. Askush s'më ka thanë gja.

— S'prish punë. Do të marrësh vesh edhe të tjera. Koha po afron. Dhe atëhere të gjithë «kuqaloshët»... Gjini s'vazhdoi. Po sheja që bani me dorë e conte deri në fund mendimin e tij. Ai vuri dorën në revole. Dhe kjo shpjegonte gjithshka.

Dom Prendi tha:

- Merrni të paktën nga nji gotë!
- Gjini e dy të tjerët lëpinë buzët:
- Nga ajo e mira, vec.
- Nga ma e vjetra — u përgjegj prifti.
- Lezja s'pati nevojë ta porositte i ungji. Solli menjéherë katër filxhana raki. Ata uruen edhe nji herë:
- Kjoftë lavdue Jezu Krishti!
- Përgjithmonë e jetës!
- E rrokullyen menjisherë.
- Edhe nga nji tjetër?
- Jo — u përgjegj Gjini — duhet të shkojmë. E, rrugës s'i dihet. Ma mirë ta kemi mendjen esëll.
- Fjalë me vend, lum djali.

Ata u përshëndetën me priftin, duelën nga kuzhina të përcjellun nga Lezja. Prifti ndëgjoi hapat e tyne të largoheshin, derën e jashtme të mbyllej e muer frymë thellë, si i çliruem nga nji barrë.

Te dera e jashtme Lezja i tha Gjinit.

— Të pres!

Ai ju përgjegj ledhatues:

— Do tē vij — dhe i shtrëngoi fort dorën.

Ata tē tre duelën jashtë, çanë terrin e thellë, tē bindun se s'do t'i kishte pa njeri.

— Edhe kësaj radhe shkoi mirë — ju drejtue Gjini shokëve.

Por jo shumë larg tyne, dy vetë shkëmbyen këtë bisedë tē shkurtën:

— Shko te shokët! Të mos ndërpritet pér asnji çast vëzhgimi! Asnji veprim! Të mendojnë se s'janë diktue. Po ti?

— Unë po i baj edhe pér pak kohë shoqni priftit... e së mbesës — u përgjegj tue qeshë lehtas tjetri.

3

Tashma s'kishte kohë pér tē fjetë. Lezja kishte ra. E kotë ta trazonte. Ai vuni xhevzen në zjarr.

«Nji kafe e mirë ja kalon çdo gjaje — mendoi tue nuhatë, i kënaqun, aromën e kafes së freskët.

E piu me shije tē madhe. Nxuer letrën që i kishte dhanë Gjini e filloï ta lexonte. Rrudhi vetullat, shfreu disa herë. E qortonin se nuk po e zgjanonte veprimtarinë e tij, se, në aq kohë, s'kishte mundë tē rekrutonte askend.

E kishin lehtë ata. Kujt t'i drejtohej? Kujt t'i besonte? Ai shkelte mbi një prush përcëllues. Jo, s'ishte punë frike, por kujdesi. E, prapë e ndjente se duhej tē bante diçka. Po çfarë? Si?

E kotë. Tani s'i vinte ndër mend asgja. Ma vonë, kushedi...

Ishte ba vonë. Duhej tē shkonte në kishë, tē conte meshë. Paloka, ndihmësi i tij, me siguri e priste. Dhe Paloka, edhe pse s'e thoshte, s'ishte nga ata, që e duronte pritjen.

Si ojithnji, e gjeti para portës.

Dom Prendi e përshëndeti. Paloka i ktheu përshëndetjen, si pa qejf.

- A ka ardhë kush? — e pyeti prifti.
- Askush — tha tjetri.
- Njerëzit e kanë lanë udhën e zotit, Palokë.
- Por zoti asht i madh dhe i mëshirshëm, Dom Prend.

Ky i nguli sytë. Çudi me këtë fshatar. Sa besimtar që ishte! E të thuesh që ishte plak! As dyzet vjeç nuk ishte. Të tjerët shkonin punonin, ai jetonte me «lëmoshët» e Dom Prendit. Dhe sa njeri besnik! Fshatarët e kishin «kritikue» shpesh, që shërbente në kishë. Por Paloka kishte qëndrue. Madje, Dom Prendi kishte marrë vesh se Paloka, nji natë, për pak kishte qenë tue u vra me nja dy prej tyne.

Dom Prendi, për këtë, edhe e kishte falenderue, edhe e kishte qortue:

— Ki mendjen, Palokë — i kishte thanë. — S'ban me u keqë me komunistët. Ua sheh sherrin.

— E çka mund t'u shohësh atyne, veç sherrit? — ja kishte kthyte Paloka.

— Megjithkëtë, largoju ngatërrresave! Leni të flasin! Dhe, po t'u vunë shumë, s'kemi ç'të bajmë, ikë prej meje! Me qeverinë s'mund të kapemi.

Ndihmësi e kishte shikue me keqardhje e i ishte përgjegjë:

— S'ndahem prej teje, edhe po më vranë. Veç në qoftë se më qet jashtë ti vetë.

Dom Prendi ishte prekë nga kjo bësnikëri.

— Ti e di sa të due, Palokë.

— E, mirë, atëhere qoftë mbyllë kjo bisedë, Dom Prend.

Dhe biseda ishtë mbyllë. Me gjithë shpotitë e kritikat e fshatarëve, Paloka s'ishte shkitë nga prifti.

Ky, kur kishte hy në «valle» — si shprehej vetë — mendoi nji herë ta futte edhe Palokën. Mund t'i sillte shumë shërbime. Por, pastaj, tue e peshue punën ma mirë, e kishte gjetë të udhës mos ta përzinte. Nuk mund të thojshe që Paloka ishte budalla. Jo, madje, ndonjisherë, Dom Prendit i krijohej përshtypja e çuditshme,